

familjen e tij në Petrovë/Petrovo. Kur në korrikun e vitit 1998, pjesëtarët e UÇK-së e nxorën Hetemin nga shtëpia [të shikohet regjistrimi], familja e tij e braktisi fshatin, ndërsa Selimi qëndroi në shtëpi me mbesën Lumturijen. Në datën **2.08.1998**, forcat serbe e bombarduan fshatin Petrovë/Petrovo. Selimi rastisi të ishte në oborr, kur një granatë eksplodoi në afërsi të tij [**Petrovë/Petrovo**] dhe e plagosi rëndë. I biri i tij i dytë, Rexha, e dërgoi në spital të Shtimes/Štimlje, ndërkaq më pas në Prishtinë/Priština. Atje iu nënshtrua intervenimit kirurgjikal, por pas gjashtë ditësh ndërroi jetë [8.08.1998]. Ai u varros më 10.08.1998 në varrezat e fshatit Petrovë/Petrovo.

**Burimet:** deklarata N.N, FDH-23599; deklarata R.R, FDH-20975.

### **Nazim (Liman) Hysenaj**

(26.06.1984, shqiptar nga Petrova/Petrovo, komuna e Shtimes/Štimlje, nxënës)

### **Mejreme (Liman) Hysenaj**

(26.09.1996, shqiptare nga Petrova/Petrovo, komuna e Shtimes/Štimlje)

Limani dhe Nexhmia kishin katër fëmijë: Nazimin, Mejremen, Agimin dhe Arsimin. Pranë shtëpisë së tyre në **Petrovë/Petrovo**, gjendej shtëpia e vëllait të Limanit, Selmanit, dhe familjes së tij. Që të dy familje kishin strehuar refugjatë nga Shtimja/Štimlje dhe Carraleva/Crnoljevo, në muajin korrik të vitit 1998. Në fillim të muajit gusht të vitit 1998, forcat serbe shpeshherë e bombardonin fshatin. Në datën **10.08.1998** ishte qetësi, prandaj të gjithë kishin dalë në oborr. Rreth orës 13:00, një predhë e kishte qëlluar murin në mes të oborrit të Limanit dhe Selmanit. Cufllat e predhës e qëlluan Mejremen e vogël në gjoks dhe qafë, Nazimiun në kokë, ndërsa familjarët e tjerë në duar dhe këmbë. Nazimi ndërroi jetë në vend. Nipi i Limanit menjëherë i barti të plagosurit te mjeku Vezir Bajrami. Ai kishte konstatuar vdekjen e Mejremes. Nazimi dhe Mejremja u varrosën po atë ditë në varrezat e fshatit Petrovë/Petrovo.

**Burimet:** deklarata S.H, FDH-23603; FDH, Që

*njerëzit ti mbajnë në mend njerëz, pyetësor, FDH-31814; deklarata H.L, FDH-33916.*

### **Fejzë (Ruhan) Fejzullahu**

(22.02.1905, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk, një fëmijë)

Fejza i moshuar jetonte me të birin Mustafen dhe familjen e tij në Carralevë/Crnoljevo. Për shkak të sëmundjes dhe moshës, ai ishte i palëvizshëm. Në qershor të vitit 1998, e gjithë familja, për shkak të luftimeve në mes të forcave serbe dhe të UÇK-së përreth fshatit, u zhvendos në fshatin fqinj të **Dugës/Duga**, ku i strehoi Pajazit Krasniqi. Në mëngjes më **23.08.1998**, rreth orës 7:00 të mëngjesit, forcat serbe serish e bombarduan fshatin Dugë/Duga. Banorët e fshatit kishin ikur, ndërsa Fejza dhe Mustafa qëndruan në shtëpi. Së shpejti, në fshat kishte hyrë këmbësoria serbe, kështu që edhe Mustafa kishte ikur. Në shtëpi kishte mbetur vetëm Fejza. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Familja u kthehe në fshat në muajin qershor të vitit 1999. Atëherë, nga një mik i Mustafës dëgjuan se atë ditë [23.08.1998], rreth orës 15:00, ai kishte hyrë në shtëpinë e Pajazit Krasniqit dhe e kishte parë trupin e Fejzës. E kishin vlarë me dy plumba. E kishte mbuluar me batanije dhe ka ikur. Të nesërmen, Mustafa e kishte lajmëruar KFOR-in. Ekipi i patologëve ndërkombëtar i ka gjetur mbetjet mortore në shtëpinë e Pajazit Krasniqit dhe i mori me vete. Deri në ditën e sotme, familjarët nuk u informuan nëse ato mbetje mortore i takojnë Fejzës. Në listën e KNKK-së, zhdukja e tij është evidentuar në lëndë me numër BLG-803537-01.

**Burimet:** deklarata B.F, FDH-36458; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### **Xhemajl (Rasim) Rexha**

(10.06.1961, shqiptar nga Papazi/Papaz, komuna e Suharekës/Suva Reka, pjesëtar i UÇK-së)

Xhemajli aderoi në UÇK në muajin qershor të vitit 1998. Në datën **23.08.1998**, atë e plagosën rëndë në **Llanishtë/Lanište**. Bashkëlufëtaret e bartën në spitalin në